



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 29.09.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 22.09.2022 dhe datë 23.09.2022.
2. Mbi kërkesën e OST sh.a., për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 2, të vendimit të ERE nr. 78, datë 13.04.2022, “Mbi rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020”.
3. Mbi licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.
4. Mbi licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Gostima 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, Gostima 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW, Gostima 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW, Gostima 4” me kapacitet të instaluar 7396 kW, Gostima 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW, Gostima 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW dhe Gostima 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW, me kapacitet total të instaluar 48 864 kW.
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregimit të energjisë elektrike me nr. 480, seria T21, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 25.01.2021.